



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.103 dt.03.07.1998

**MBI**

**NDRYSHIM DESTINACIONI TE FONDEVE TE MIRATUARA PER  
CDOGANIMIN E KALDAJES, DHURATE NGA MANTOVA.**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, me vendimin Nr.195, dt.15.12.1997, pika.8, ka miratuar shumën prej 1.500.000(njëmilion e pesëqindmijë) lekë, për çdoganimin e kaldajës dhuratë nga Dhoma e Tregëtisë së Mantovës për godinën e Bashkisë.

Meqenëse kaldaja kaloi pa vlerën e çdoganimit, bazuar në V.K.M. Nr.38, dt.31.01.1994 “Për trajtimin e ndihmave humanitare falas”, dhe pasi dhuruesit kanë hequr dorë nga montimi, Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme paraqiti kërkesën për fondin për kryerjen e këtij operacioni në shifrën prej 2.000.000 (dy milion) lekë.

Këshilli i Bashkisë në mbështetje të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, neni.14/5 dhe të Ligjit Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, dhe duke e konsideruar të drejtë kërkesën e kësaj Drejtorie :

**V E N D O S I**

- 1. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të fondit prej 1.500.000 (një milion e pesëqindmijë) për montimin e kaldajës dhe ndërtimet e nevojshme për këtë qëllim.**
- 2. Të miratojë edhe shtesë fondi prej 500.000 (pesëqint mijë) lekë, duke arritur në vlerën totale për montim kaldaje dy milion lekë.**

- 3. Ngarkohet për ndjekje dhe zbatim të këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe Drejtoria e Financës.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**